



2253  
09.07.2018



- Senati  
- Pres. Presed.  
O. Blunç

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 7215 Prot.

Tiranë, më 05.07. 2018

URDHËR

Nr. 366, datë 05.07.2018

PËR

MIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër, propozuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 91 datë 02.03.2018, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri (44 faqe).
2. Të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër të miratohen në zbatim të Statutit të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër dhe kuadrit ligjor në fuqi.
3. Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, brenda afatit ligjor, të paraqesë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të gjitha aktet dhe dokumentacionin ligjor për organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, sipas përcaktimeve të këtij statuti.
4. Ndryshimet në statutin e Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër miratohen sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe këtij statuti.
5. Statuti ekzistues i Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër, i miratuar me Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (i shfuqizuar), shfuqizohet.
6. Statuti i Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër hyn në fuqi, pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Arsimit Rinisë dhe Sportit dhe Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

LINDITA NIKOLLA

